



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	28 - 07 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetj. Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHUK	5390/2023		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.858/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Vjollca Sinani- Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në rastin e ankesës A.nr.858/2023 e datë 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë, [redacted] kundër organit të punësimit/ Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.858/2023 të datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas akt emërimit nr.12/112-2418 të datës 30.12.2011 në pozitë të "Zyrtarit për Rini dhe Sport" në kuadër të Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Vitisë me datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4800/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me kategorizimin e pozitës së punës së tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.06.2023, përmes shkresës zyrtare ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa kjo e fundit me datën 30.06.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë fazës së shqyrtimit të kësaj ankese në ndërkohë më datë 04.07.2023 ankuesi fizikisht ka parashtruar kërkesë me të cilën ka bërë tërheqjen e ankesës së datës 16.06.2023 për arsye personale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, duke marrë për bazë kërkesën e tërheqjes së ankesës së datës 04.07.2023 ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ në lidhje me ankesën e ankuesit [redacted] është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi sipas akt emërimit nr.12/112-2418 të datës 30.12.2011 mbanë pozitën e "Zyrtarit për Rini dhe Sport" në kuadër të Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Vitisë, ndërsa gjatë procesit të vendimmarrjes së këshillit i njëjti më datë 04/07/2023 ka parashtruar shkresën zyrtare-kërkesën me numër të protokollit 5005/2023, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 16.06.2023 për arsye personale. Kolegji i Këshillit në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.858/2023, datë 27/07/2023.

Vjollca SINANI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së